



Duke u bazuar në nenin 43, 45 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenin 47 të Statutit të Komunës së Klinës Nr. 01-110-1232/2010. Nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës si dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

F T E S Ë

Ftohën të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit e tjerë që të marrin pjesë në seancën e **VI-të të rregullt të punës së kuvendit për vitin 2026.**

Seanca mbahet **më 26.06.2026 (e Premte)**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon **në orën 10:00.**

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky:

R E N D I I D I T Ë S

1. Arsyetimi i mungesave;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 29.05.2026;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) nga mbledhja e mbajtur më 09.06.2026;
4. Shqyrtimi i raportit nga procesi i konsultimit publik për Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027–2029 (ref. Grupi Punues);
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027–2029 (ref. Drejtoria për Financa);
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2026 (ref. EKZ);
7. Raportimi i Kryetarit të Komunës për rrjedhat qeverisëse në Komunën e Klinës gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, të arriturat, vështirësitë, synimet dhe investimet kapitale (raporton Kryetari i Komunës);
8. Raportimi lidhur me performancën komunale për vitin 2025 (ref. EKZ);
9. Informata lidhur me menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Klinës (ref. DSHPE);
10. Pyetje dhe përgjigje.

01Nr 06-16591 2026
Klinë, me 15.06 2026



Kryesuesi i Kuvendit,
Enver Berisha